



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:208136

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05435258

P.nr.1017/2

1

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm – Divizion Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Arlind Sharani, me procesmbajtësin Amar Hoxha, në lëndën penale kundër të akuzuarve A.K., dhe B.K., që të dy nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nën par. 3.1 lidhur me par. 1 nën par. 1.1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP/IL.nr.1604-1/21, të datës 16.09.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datën 11.03.2024, në prezencën e Prokurorit të shtetit Ramadan Koro, të akuzuarve, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, dhe me datën 11.03.2024 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. A.K., nga i ati, e ëma, e gjinisë, i lindur menë Prizren, ku edhe tani banon në rrugën “.....” p.nr. përball marketit “.....”, i shkurorezuar-baba i 3 fëmijëve, i pa punë, ka të kryer fakultetin juridik, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës, me numër të letërnjoftimit

2. B.K., nga i ati, e ëma, e gjinisë, i lindur menë Prizren, ku edhe tani banon në rrugën “.....” p.nr. përball marketit “.....”, është me punë të përkohshme në shtetin e Zvicërs, i martuar-baba i 5 fëmijëve, kuzhinier, ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës, me numër të letërnjoftimit

JANË F A J T O R

Me datë 10.08.2021, rreth orës 10:00 minuta, në rrugën “.....” pa.nr. në Prizren, saktësisht në shtëpinë e tyre të përbashkët familjare, me dashje dhe në bashkëveprim i shkaktojnë lëndime të lehta trupore të dëmtuarës respektivisht viktimës së ndjeshme H.K., në atë mënyrë në momentin kur e dëmtuara H.K., kërkon nga bashkëshorti i saj i pandehuri A.K., që e njëjta të shkoj me fëmijët në pishinë, aty lindë mosmarrëveshja në mes tyre ku edhe i pandehuri e sulmon fizikisht të dëmtuarën respektivisht bashkëshorten e tij H.K., në momentin kur e dëmtuara fillon të përgadis gjërat e saja personale që të shkoj në familjen e saj aty i pandehuri respektivisht kunati i saj B.K., të njëjtën e sulmon fizikisht duke e goditur me

duar, mëpastaj i pandehuri B., vazhdon ta kap për flokësh të dëmtuarën, ta ngreh zvarë në oborrin e shtëpisë si dhe ta godas me shqelma, me të cilat veprime të pandehurit në bashkëveprim i shkaktojnë lëndime të lehta trupore të dëmtuarës H.K., të cilat lëndime paraqesin ndrydhje të indeve të buta të kokës në regjionin tëmthor zverkor të djathtë, në mollëzon e djathtë të fytyrës, në krahun e majtë, në kofshën dhe kërcirin e këmbës së majtë, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore, këto dëmtime shoqërohen me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, të konstatuar si në akt ekspertimin mjeko ligjor, të ekspertit mjeko ligjor Prof.As. Dr. F.B., datës 30.08.2021.

Me këto veprime kanë kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nën par. 3.1 lidhur me par. 1 nën par. 1.1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17 par.1, 38, 40, 42, 43, 44, 69, 70, dhe nenit 185 par.3 nën par. 3.1 lidhur me par. 1 nën par. 1.1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe nenit 364 të KPPRK-së të akuzuarit i:

G J Y K O N:

Të akuzuarin A.K.,:

ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj.

Me kërkesën dhe pëlqimin e të akuzuarit konform nenit 44 të KPRK-së, Dënimi Me Burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, të akuzuarit A.K., **I ZËVENDËSOHET ME DËNIM ME GJOBË** në shumën prej tetëqind euro (800 €), të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej një (1) muaji nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të akuzuarin B.K.,:

ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj.

Me kërkesën dhe pëlqimin e të akuzuarit konform nenit 44 të KPRK-së, Dënimi Me Burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, të akuzuarit B.K., **I ZËVENDËSOHET ME DËNIM ME GJOBË** në shumën prej tetëqind euro (800 €), të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej një (1) muaji nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse të akuzuarit nuk dëshirojnë ose nuk mund ta paguajnë dënimet me gjobë, atëherë iu zëvendësohen dënimet me gjobë me dënime me burgim, ashtu të akuzuarve A.K., dhe B.K., secilit veç e veç me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 40 (dyzetë) ditëve, duke iu llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20€ (njëzet euro).

Detyrohen të akuzuarit A.K., dhe B.K., që ti paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësor dhe atë secili veç e veç në shumën prej 30€ (tridhjetë euro), në emër të shpenzimeve të ekspertit mjeko ligjor për ekspertizë në mënyrë solidare shumen prej 20€ (njëzet euro), ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit secili veç e veç shumën prej 20€ (njëzetë euro), të gjitha këto në afat prej 1 (një) muaji nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara H.e (Q.) K. nga fshati, e Komunës së Vushtrisë, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest juridiko-civil.

Ar sy e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/II.nr.1604-1/21, të datës 16.09.2021, kundër të akuzuarve A.K., dhe B.K., që të dy nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nën par. 3.1 lidhur me par. 1 nën par. 1.1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

I akuzuari A.K., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, i vije keq për rastin që ka ndodhur, premtion gjykatës që në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm.

I akuzuari B.K., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, është penduar për veprën penale, premtion gjykatës që në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm.

Prokurori i shtetit Ramadan Koro, në fjalën përfundimtare ka theksuar se në këtë çështje penale pas pranimit të fajësisë nga ana e gjykatës, është vërtetuar gjendja faktike si në aktakuzë, propozon gjykatës të akuzuarit të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit. Gjykatës me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit i propozon që të ketë parasysh rrethanat lehtësuese siç është pranimi i fajësisë, kërkim falja dhe pendimi për veprën e kryer, ndërsa si rrethanë rënduese të ketë parasysh dashjen e të akuzuarve, faktin se vepra penale është kryer brenda familjes, dhe se e dëmtuara është viktimë e ndjeshme.

Në fjalën përfundimtare i akuzuari A.K., ka deklaruar: se është penduar për veprën penale të kryer, me të dëmtuarën raportet i ka rregulluar, është duke paguar me rregull alimentacionin për fëmijët, ditën kritike ka qenë një moment i çastit kur është kryer vepra penale, dhe i premtion gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të këtilla, më herët nuk ka pasur probleme me ligjin.

Në fjalën përfundimtare i akuzuari B.K., ka deklaruar: se kërkon falje për veprimet që kanë ndodhur ditën kritike, është penduar për veprën penale, me të dëmtuarën i ka raportet e mira, asnjëherë nuk ka pasur problem me ligjin dhe kërkon nga gjykata që të shqiptojë një dënim sa më të butë.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 322 lidhur me nenin 242 par. 2 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 248 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

- se të akuzuarit A.K., dhe B.K., me dashje kanë kryer veprën penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 185 par.3 nën par. 3.1 lidhur me par. 1 nën par. 1.1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përkthuar si në dispozitiv të Aktgjykimit.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 185 par.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale lëndimi të lehtë trupor e kryen: “Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor”, ndërsa nën paragrafi 1.1 ka përcaktuar se “kur kemi dëmtim të përkohshëm ose dobësimin e ndonjë organi apo pjese të trupit të personit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet”. Ndërsa paragrafi 3 është paraparë forma e cilësuar ka përcaktuar se: “Kur vepra penale nga ky nen kryhet ndaj viktimës së ndjeshme, ose është e motivuar sipas kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit fetar, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njërin nga këto karakteristika të mbrojtura kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.”

5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Andaj, duke u bazuar edhe në gjendjen e vërtetuar faktike, gjyqtari i vetëm gjykues duke u bazuar në dispozitat ligjore të lartpërmendura, i ka shpallur fajtor të akuzuarit A.K., dhe B.K., për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga 185 par.3 nën par. 3.1 lidhur me par. 1 nën par. 1.1 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtëve i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese për të akuzuarin A.K., gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: është mbajtës i familjes baba i 3 fëmijëve të mitur, është i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, pranimin e fajësisë në shqyrtimin gjyqësor, pendimin e tij duke i kërkuar faljen publike të dëmtuarës dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale dhe se do të jetë më i kujdesshëm, faktin se me të dëmtuarën janë pajtuar, poashtu e kaluara kriminal e tij, fakti se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale, ndërsa si rrethana rënduese ka gjetur se veprën penale e ka kryer me dashje direkte, vepra është kryer brenda në familje në prezencë të anëtarëve të familjes. Për të akuzuarin B.K., si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar se është baba i pesë fëmije, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, pranimin e fajësisë në shqyrtimin gjyqësor, pendimin e tij duke i kërkuar faljen publike të dëmtuarës dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, e kaluara kriminal e tij, fakti se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale, ndërsa si rrethana rënduese ka gjetur se veprën penale e ka kryer me dashje direkte, vepra është kryer brenda në familje në prezencë të anëtarëve të familjes. Prandaj duke pas parasysh të gjitha faktet, arsyet dhe rrethanat e përmendura më lartë, gjykata ndaj të njëjtëve ka shqiptuar dënimin me burgim, duke qenë i bindur se dënimi i

shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëj rehabilitimin e tyre, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Zëvendësimi i dënimit me burgim në dënim me gjobë

Gjyqtari i vetëm gjykues, duke u bazuar në nenin 44 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarve, dënimin me burgim të shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi i ka zëvendësuar me dënim me gjobë në shumën që është shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke i marr për bazë rrethanat e lartcekura.

8. Vendimi për realizimin e kërkesës pasurore-juridike

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt juridiko - civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 462 par.2 të KPP-së.

9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 452 par. 1 të KPP-së, ndërsa për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 364 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.1017/21, me datë 11.03.2024

Zyrtari Ligjor
Amar Hoxha

Gjyqtari i vetëm gjykues
Arlind Sharani

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.